Mbrojtësia e personit nën hetim: "Të revokohet masa e sigurimit pasi nuk plotësohen kushtet dhe kriteret për vazhdimin e masës së caktuar. Rregullorja e brendshme e ASHK, ish ZVRPP nuk përcakton detyrimisht që regjistri fizik duhet të nënshkruhet nga drejtuesi, por edhe në rast të kundërt do të ishte përgjegjësi administrative, mungesa e nënshkrimit dhe vulosjes. Për sa i



përket veprës penale, nuk plotësohen elementët e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës". Në lidhje me objektin e kësaj vepre, në këtë rast nuk është cenuar veprimtaria e rregullt e ASHK. Në lidhje me anën objektive nuk ka veprime ose mosveprime të personit nën hetim që të përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës së tij. Nga ana subjektive mungon elementi dashje nga personi nën hetim.

Në ASHK ka disa hallka dhe secili prej punonjësve ka përgjegjësinë e tij. Në këtë rast ka qenë përgjegjësja e zonës që i ka paraqitur praktikën drejtuesit pa kryer verifikimet. Përgjegjësi i zonës shpërndan punën tek specialistët dhe jo drejtuesi. Specialistët kur përfundojnë detyrën lënë shënimet përkatëse. Përgjegjësja e zonës ia ka vënë në dispozicion praktikën drejtorit me dokumentacionin ligjor që i duhet drejtorit për të verifikuar pasi nuk verifikon çdo detaj. Drejtuesi kontrollon vetëm dokumentacionin kryesor. Dokumentacionet e tjera kontrollohen nga hallkat e tjera të sistemit.

Për sa i përket mungesës së nënshkrimit në regjistrat fizikë, në momentin që do të paraqitej një kontroll dhe do të verifikohet që nuk ishin vulosur nga ana e drejtuesit, do të konsiderohej shkelje administrative. Duhet të kihet parasysh volumi i punës në këtë agjenci dhe fakti që janë bërë për një periudhë të shkurtër kohe dhe institucioni nuk ka pasur vetëm këto praktike por ka pafund të tjera dhe këto do të firmoseshin nga titullari në një moment të dytë. Ndër të tjera, lëshimi i certifikatave nuk ka asnjë pasojë pasi referuar vendimit unifikues Certifikata nuk të bën pronar.

Aktet nënligjore nuk zbatohen, pasi meqenëse me Ligjin për Kadastrën janë bashkuar ish ALUIZNI dhe ish ZVRPP Durrës, atëherë cila prej dy rregulloreve do zbatohet. Në këtë rast nuk zbatohen.

I arrestuari është me arsim të lartë me integritet, ka kryer gjithmonë detyra të rëndësishme shtetërore, nuk ka pasur në veprimet e tij ndonjë shkelje që të ketë sjell pasojë, është babai i dy fëmijëve të mitur".

Personi nën hetim i cili deklaroi: "Jam dakord me avokaten. Të revokohet masa e sigurimit. Për këtë pasuri janë 12 Kontrata sipërmarrje me pronarët e truallit, të cilat janë lehtësisht të verifikueshme. Të gjithë kufizimet për pasuritë për pjesët takuese, për pronarët janë të regjistruara, pra në momentin që dikush do të vij për të bërë një transaksion, kufizimi do të reflektohet në kartelën dixhitale. Transaksioni është i pamundur. Kufizimin në regjistrin fizik unë nuk e kam parë, por në regjistrin dixhital ku do të printohej kartela, sepse kjo pasuri është hedhur në mënyrë dixhitale në sistemin tonë, të gjitha pasuritë janë të kufizuara. Duhet të ketë përputhje midis regjistrit dixhital dhe atij fizik. Certifikatat i lëshohen subjektit sepse dokumentacioni ka qenë i plotë, por transaksioni nuk lejohet. Nëse ka një transaksion atëherë ka përgjegjësi.

Kur ka problematika, diskutohen me përgjegjësin e zonës sepse filtri i parë nuk është drejtuesi, hallka e mesme është përgjegjësi i zonës. Ai garanton që dokumentet, nga aplikimi deri kur të vij në zyrë ime, të jenë të plotësuar konform ligjit, për të gjitha praktikat. Në rast se drejtuesi nuk do të ishte jurist por do të ishte ekonomist, çfarë pretendime do të ngriheshin për atë që nuk ka formim në jurisprudencë. Për këtë arsye janë hallkat. Përgjegjësi i zonës për këtë praktikë nuk më ka paraqitur asnjë problem dhe ka sjellë praktikën, pas një muaji me vonesë dhe është nënshkruar si një praktikë e rregullt, pasi është detyrim ligjor i zyrës që ta regjistroj.

Pasi vjen praktika nga përgjegjësi, në momentin e aplikimit kontrollohet vetëm dokumentacioni bashkëlidhur, sepse një praktikë e punuar për dy muaj, unë nuk kam kohë fizike që ta rishohë. Shoh vetëm dokumentacionin e përcjell pra është leja e shfrytëzimit, leje e ndërtimit, leja e përdorimit, është e përcjell në mënyrë zyrtare, është e aplikuar, është bërë mandatpagesa, është

reflektuar në referencat e mëparshme kontrata e sipërmarrjes. Në kë rast më rezultoi se kontratat e sipërmarrjes janë të regjistruara me pronarët e truallit dhe sipërmarrësit ndërtuesit. Këto kontrata kanë qenë në volumin e truallit që më parë. Janë dy volume. Është paqësoria mëmë truallit ku kanë qenë të gjitha të regjistruara dhe janë hapur volume të reja me ndërtesën tashmë sepse ndërtimi ka mbaruar. Në dijeninë time, pasi unë nuk mund të kontrolloj volumet fizike, në sistemin dixhital të gjitha këto janë të vendosura dhe është lehtësisht e verifikueshme. Nëse ka pasur problematika, administrative, kanë qenë për shkak të ngarkesës, vonesës, situatës së punës, pushimet verore, puna me gjysmë stafi, problematikave në sistem të cilat ne i referojmë gjithë kohës. Megjithatë këto janë çështje administrative të zyrës dhe nuk kanë të pasoja juridike të paktën me tjetërsimin e pronës.

Ditën e qyrrjes së sistemit, ka pasur probleme teknike të tij”.

VËREN:

I. Rrethanat e faktit dhe Procedura.

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka paraqitur pranë kësaj gjykate kërkuesin për “Verifikimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale për personin nën hetim ... i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”.

2. Nga studimi i akteve të procedimit penal rezulton se, mbi bazën e informacioneve të marra në trugë operative është marrë dijeni se në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Durrës ishte bërë regjistrimi fillestar i një numri të konsiderueshëm të pasurive të paluajtshme, në favor të subjektit investitor “ ... ” sh.p.k, në volumet e regjistrimit me numër ... të Katundit ... , Zona Kadastrale ... , në kundërshtim me ligjin.

3. Sipas Procesverbalit të qyrrjes dhe sekuestrimit të dokumentacionit në A.Sh.K-në Durrës dhe pyetjes së personave që kanë dijeni për rrethana të hetimi ka rezultuar se ekzistojnë dy kontrata sipërmarrjeje në këtë praktikë regjistrimi: Kontrata e Sipërmarrjes nr. ... Rep dhe nr. ... Kol, datë05.2007, e hartuar përpara noteres publike ... dhe Kontrata e Sipërmarrjes me nr. ... Rep dhe nr. ... Kol, datë05.2010 e hartuar përpara noterit publik ... , lidhur midis subjektit ndërtues ... sh.p.k dhe pronarëve të truallit. Në Kontratën e Sipërmarrjes nr. ... Rep dhe nr. ... Kol, datë05.2007 e hartuar përpara noteres publike ... , lidhur midis subjektit investitor ... sh.p.k dhe pronarit ... , palët ndër të tjera kanë rënë dakord: “Sipërmarrësi merr përsipër të kalojë në pronësi të porositësit pronarit të truallit 28 % të sipërfaqes së ndërtimit mbi kuotën 00..Me mbarimin e ndërtimit, sipërmarrësi nëpërmjet kontratës së shkëmbimit për truallin do ti kalojë në pronësi, sipërfaqen ndërtimore sipas përqindjes së caktuar në këtë kontratë...”

4. Nga sekuestrimi i tre volumeve me numra ... të katundit ... rezultoi se të gjitha shënimet e bëra për regjistrimin fillestar të këtyre pasurive nuk janë të nënshkuara nga specialisti jurist që ka përpiluar praktikën, madje në shumë fletë nuk rezultoi i shënuar

emri i juristit që e ka bërë përpunimin e praktikës. Është konstatuar gjithashtu se nga ana e drejtuesit të institucionit nuk është bërë nënshkrimi dhe vulosja e regjistrimit fizik.

5. Nga verifikimi në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim fillestar të kësaj praktike rezultojnë se mungojnë kontratat e sipërmarrjes me pjesët takuese të individualizuara të pronarëve të truallit, mbi bazën e të cilave do të mund të bëhej kufizimi i saktë i njërive në favor të tyre. Ndërkohë ky fakt rezultoi edhe nga shkresa e njëanshme (e subjektit "..." sh.p.k), jo noteriale, "Lista e pronarëve të truallit pjesa takuese" si dhe deklarata e shoqërisë "..." sh.p.k, datë "..." 06.2019, drejtuar ASHK Durrës, në të cilën pasqyrohet: "Deklarojmë se shoqëria "..." sh.p.k ka aplikuar pranë ASHKD për regjistrim përfundimtar të objekteve të reja në bazë të Certifikatës së Përdorimit Nr. "..." prot, datë "..." 05.2019, lëshuar nga AZHT. Për këtë arsye kërkohet vazhdimin e procedurave të regjistrimit të objekteve dhe kufizimin e veprimeve për pronarët e truallit në seksionin L, deri në realizimin e kontratës së shkëmbimit. Bashkëlidhur lista e objekteve të specifikuar për pronarët e truallit".

6. Nga dosja që është marrë me cilësinë e provës dokument rezultojnë se personi që ka bërë aplikimin në favor të shoqërisë, nuk ka paraqitur akt përfaqësimi ose tagër të dhënë nga shoqëria për kryerjen e këtyre aplikimeve.

7. Ndërkohë, pavarësisht mangësive të konstatuara në praktikën për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, mbi bazën e aplikimeve nga personi juridik "..." sh.p.k, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Durrës janë lëshuar Certifikatat e Pronësisë, të gjitha me datën 15.07.2019, nënshkruar nga drejtuesi i institucionit dhe janë kryer transaksione me persona të tretë, ku nga provat e paraqitura u evidentua se në kartelat e pasurive nuk janë shënuar kufizimet përkatëse, në favor të pronarëve të truallit, kusht ky i kërkuar shprehimisht nga Ligji Për Kadastrën dhe aktet nënligjore në fuqi. Ky fakt rezultoi nga inventari i dosjes për secilën pasuri dhe kartelat e tyre respektive: Pasuritë e paluajtshme: nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "..."; nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "..."; nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "..."; nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "..."; Nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "..."; nr. "...", vol. "...", fq. "...", Zk "..."; nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "..."; nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "..."; nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "..."; nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "..."; nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "..."; nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "..."; nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "..."; nr. "...", vol. "...", fq. "...", ZK "...".

8. Nga pyetja e shtetasve "..." e rezultojnë se nuk ka shënime në sistemin e të dhënave I.P.S (sistemi elektronik) se kjo praktikë është përfunduar sikurse dhe nga ana e subjekteve që u është caktuar kjo detyrë nuk ka asnjë dokument të shkruar, që të provojë se regjistrimi i praktikës është kryer plotësisht. Këta shtetas kanë deklaruar si më poshtë:


9. Sipas Procesverbalit të pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit "..." ai ka deklaruar se: "Lidhur me pyetjen dua të sqaroj se unë i kam të njohura këto dokumente që ju më paraqisni. Këto kontrata i përkasin ndërtimit të kryer nga shoqëria "Lura" sh.p.k, banim ose shërbim. Në lidhje me çfarë veprimesh kam kryer unë sqaroj se këtë praktikë fillimisht e merr shefja e zonës, e cila e shpërndan tek një jurist dhe një hartograf... Unë vetë nuk kam nënshkruar asnjë nga këto harta, por që deklaroj se i kam hartuar unë për aq të dhëna sa i thashë më lart...Juristja që ka punuar këtë praktikë ka qenë "..." Kjo ishte hera e dytë"



që unë merrja materialin sepse sheffa e zonës e mori dhe u rishpërnda prapë, sepse ishte voluminoze dhe e madhe e nuk arrihej dot...Në lidhje sa më sipër në dijeninë time nuk janë bërë transaksione të tilla, që nuk cenojnë kontratën e sipërmarrjes, ku përcaktohet se pronarët e truallit marrin këtë njësi ose pasuri përkatëse...".

10. Sipas Procesverbalit të pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit **** ai ka deklaruar se: "Lidhur me pyetjen tuaj dua të sqaroj se unë sot po i shikoj për herë të parë. Ndërkohë nga përmbajtja e tyre më kujtohet se unë kam kryer veprime formale për regjistrimin e tyre, që konsistojnë vetëm në hedhjen në regjistrin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, zkt ... numrat e regjistrave ... pjesërisht, katundi ... Unë kam vepruar se më ka kërkuar ndihmë ... e cila është edhe në rang hierarkik më të lartë se unë, por është edhe juristja që ka përpiluar praktikën dhe mban përgjegjësi për këtë regjistrim...Një pjesë të certifikatave i kam printuar unë nga sistemi, pasi ato nuk dali nga sistemi po nuk u fut një punonjës i zyrës së ASHK-së dhe në sistem lihen gjurmë. Pra një pjesë i kam printuar unë dhe një pjesë ... që ka kodin e saj. Pasi bëhet praktika i dërgohet gjithë dosja Drejtorit të ASHK-së që bën edhe verifikim përfundimtar të së gjithë praktikës, dhe nëse ka problem nuk i firmos certifikatat duke i këhyer mbrapsht për rishikim. Në këtë rast unë kam dërguar praktikën tek drejtori por me këtë procedurë fizikisht nuk e di kush e ka dërguar, por logjikisht duhet ta ketë dërguar specialistja që e ka firmosur fletën e inventarit...Drejtori kur e gjen me shkelje praktikën nuk e nënshkruan dhe e këhen për rishqyrtim...Dua të theksoj se investitori në cilësinë e pronarit në momentin e regjistrimit fillestar nuk mund të realizojë kontrata shitblerje përfundimtare me palë të treta, nëse nuk janë përcaktuar njësitë e individualizuara të pronarëve të truallit...Specialisti jurist ka detyrim ligjor që në çdo kartelë pasurie të vendosë nënshkrimin e vet. Në rastin e regjistrimit të kësaj praktike, të gjitha praktikat e regjistruara duhet të nënshkruheshin nga ... pasi ajo ka marrë praktikën për ta punuar. Sipas detyrës funksionale ajo nuk duhet ta kishie mbajtur vetë praktikën për ta punuar, pasi është sektor tjetër që ka për detyrë marrëdhëniet me të tretë që kanë ankesa...Veprimet në regjistër i kam bërë me mirëbesim, duke i hedhur fizikisht për të ndihmuar kolegen, por nuk kam nënshkruar në asnjë vend dhe nuk kam asnjë përgjegjësi për praktikën..."

11. Sipas Procesverbalit të pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit **** datë 20.09.2019 ajo ka deklaruar se: "Sot po i shikoj për herë të parë këto kontrata. Ndërkohë nga përmbajtja e tyre nuk më kujtohet të kem kryer asnjëherë veprime në lidhje me këto palë dhe as me këto pasuri. Unë ndaj thjesht 100 aplikime në ditë dhe memoria është shumë e ngarkuar. Për një përgjigje më të saktë duhet të shoh praktikën dhe sistemin...Pas pranimit në sportelin e aplikimit dhe përfundimin e pagesave të tarifave të shërbimit, praktika kalon në sektorin e arkivës për tu skanuar, veprim të cilin e bën operatori. Pas kësaj praktika kalon tek unë si përgjegjëse për tu shpërndarë për punë tek specialistët jurist dhe hartografi. Këtë shënim për ndarje pune unë e pasqyroj tek fleta e aplikimit ku shënoj edhe emrat e specialistëve që e marrin në përpunim këtë praktikë. Mbasi ata kryejnë veprimet e tyre ma sjellin mua për ta kaluar tek Drejtori i ASHK-së për nënshkrim. Drejtori ka të drejtën e kontrollit të së gjithë praktikës për para se të nënshkruajë dhe mbas kontrollit ai bën nënshkrimin dhe lëshimin e certifikatave të pronësisë. Në rast se ai gjen parregullsi e këhen mbrapsht praktikën me shënimin përkatës dhe të detyrat përkatëse. Ai e studion vetë praktikën se është specialist i fushës, jurist. Unë shtetasen ... e njoh pasi punon në zyrën tonë, me detyrën e koordinatorës së bashkëqeverisjes. Ajo nuk punon në sektorin tim. Me sa di unë e ka llogarinë e hapur si jurist në sistemin IPS, por unë nuk i kam kaluar asnjë praktikë, nga dita që është rikthyer..".



12. Sipas Procesverbalit të pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ***
datë 23.09.2019 ajo ka deklaruar se: "...dua të theksoj se në kohën kur është bërë ky regjistrim unë kam qenë në punë. Flas për kohën që është ndarë praktika për përpunim nga ana e specialistëve, ndërkohë që në kohën kur janë printuar certifikatat ka qenë dita e parë që unë kam filluar punën, pas lejes së zakonshme vjetore...pas pyetjes tuaj të parë, jam konsultuar me sistemin IPS në lidhje me këtë rast dhe kam vënë re se këtë praktikë e kam ndarë për punim në datën 19.06.2019 duke ia lënë specialistëve . *** dhe ***
më është paraqitur dhe më ka bërë kërkesë që tja kaloj praktikën *** duke qenë se është e re në punë dhe nuk e ndjente veten të aftë që të përpunonte një praktikë të regjistrimit fillestar. Praktika më pas i ka kaluar *** dhe *** pa e ndryshuar hartografin, pasi nga *** nuk kam pasur pretendime...Sot konstatoj se në sistem është bërë shënimi në sistem nga *** dhe *** se dosja nuk u është dorëzuar fizikisht, ndërkohë që kjo gjë është e pavërtetë pasi unë di që hartat i ka punuar *** Vetë sistemi tregon se kur dosja është përfunduar, ajo nuk ka ardhur më për kontroll tek unë. Edhe sot që flasim dosja ekziston në llogari të tyre. Unë nuk e kam kaluar këtë praktikë as në sistem dhe as fizikisht, nuk e kam dërguar unë tek titullari si të përfunduar për nënshkrim, pasi nuk më ka hyrë në sistem si e përfunduar...Në qoftë se për pasuritë që regjistrohen për herë të parë në emër të subjektit nuk janë të regjistruara pjesët takuese të individualizuara, nuk kryhen veprime, ndërsa kur kontrata e sipërmarrjes është e individualizuar atëherë procedohet me pjesët takuese që nuk u takojnë pronarëve të truallit, kur aplikues është shoqëria...Të drejtën për të nënshkruar volumin e regjistrimit e ka titullari i institucionit. Kjo gjë duhet të bëhet në momentin kur verifikohet praktika dhe lëshohet certifikata. Volumi nënshkruhet nga specialisti jurist pasi ai e punon me kartelën, ndërsa hartografi vetëm me hartën. Pra çdo specialist nënshkruan faqen e volumit përkatës ku ka bërë regjistrimin dhe më pas edhe Drejtori, bën edhe ai nënshkrimin e tij dhe e vulos atë në çdo faqe..."

13. Sipas Procesverbalit të pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ***
ai ka deklaruar se: "Unë këtë dosje nuk e kam marrë asnjëherë fizikisht për përpunim dhe as nuk kam kryer asnjëherë me të. Në sistemin e të dhënave I.P.S rezulton se kjo dosje është dhënë për përpunim edhe mua si specialist jurist, por unë kam bërë shënim në llogarinë time në sistem, se nuk e kam marrë në dorë fizikisht asnjëherë këtë dosje. Unë nuk kam dijeni se kush e ka punuar këtë dosje dhe as nuk e di nëse është mbaruar si regjistrim fillestar. Mua fizikisht duhet të ma kishte dorëzuar përgjegjësjë e zonës së regjistrimit..Unë personalisht kur shikoj një regjistrim fillestar dhe kam për të përpunuar praktikën e një veprimi juridik të parë, menjëherë pas regjistrimit fillestar shkoj edhe në arkivë dhe marr materialet e praktikës së regjistrimit fillestar. Në rast se gjej probleme ia referoj me shkrim Drejtorit të A.SH.K-së, pasi ai lëshon certifikatat dhe është titullari...Në qoftë se për pasuritë që regjistrohen për herë të parë në emër të subjektit nuk janë të regjistruara pjesët takuese të individualizuara, nuk kryhen veprime, ndërsa kur kontrata e sipërmarrjes e individualizuar, atëherë procedohet me pjesët që nuk u takojnë pronarëve..."

14. Sipas Procesverbalit të pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ***
ai ka deklaruar se: "...Së pari dua të theksoj se në kohën kur është bërë ky regjistrim unë nuk kam qenë fare në punë pasi kam qenë me pushime. Së dyti edhe në raste të tjera opinion jap, pasi nuk kam asnjë tagër vendimarrës, as me shkrim dhe as me ligj, dhe as nuk dal me ndonjë akt kontrolli. Këtë gjë e bëj vetëm nëse ma kërkon Drejtori i ASHK-së...Pasi bëhet



aplikimi dhe paguhen detyrimet ndaj zyrës për shërbimet e kërkuara, dosja e skanuar nga operatori shpërndahet nga zyra e arkivës dhe kalon tek përgjegjësi i zonës së regjistrimit për tu shpërndarë për punim. Përgjegjësi i zonës ia shpërndan specialistëve juristë dhe hartografë për punim. Shpërndarja bëhet mbi bazë vendimmarrje personale e përgjegjësit të zonës, por duke mbajtur parasysh ngarkesën e punës së çdo specialisti, nisur nga aplikimet ditore që vijnë. Dosja kalon nëpërmjet gjurmës që lihet në sistemin elektronik I.P.S, ku përgjegjësi shënon emrin e specialistëve që ia ka kaluar...pasi përfundohet praktika, në rast se është e rregullt dhe e plotë me dokumentacion, i kalohet përsëri shefit të zonës, përgjegjësit të zonës së regjistrimit, i cili pasi e verifikon nëse është në rregull, e kalon për nënshkrim tek titullari. Pra fizikisht dosja kalohet nga ana e përgjegjësit të zonës, tek titullari dhe pasi e kontrollon drejtori dhe kur e gjen të rregullt e nënshkruan, ia kalon protokollit për të bërë përfundimin e shërbimit. Në rast se nuk e gjen të rregullt praktikën e kthen përsëri tek përgjegjësi i zonës për të bërë plotësimet përkatëse....Çdo kalim praktike ku caktohet një punonjës specialist ose grup pune, hidhet dhe pasqyrohet në sistem dhe nuk e merr dot praktikën dikush që nuk është i caktuar nga shefi i zonës. Caktimi i një grupi më të madh punonjësish bëhet me urdhër me shkrim nga titullari i insitucionit, me propozim të përgjegjësit të zonës..."

15. Rezulton se kjo praktikë është përpunuar nga shtetasja "..." e cila nuk e kishte të drejtën që të merite përsipër përpunimin e praktikës së një regjistrimi fillestar, pasi ajo ishte me detyrën e përgjegjëses së sektorit juridik dhe bashkëqeverisjes në këtë zyrë. Shtetasja "..." në Procesverbalin e pyetjes si person që ka dijeni për rrethana të hetimit, ka deklaruar se: "ajo së bashku me punonjës të tjerë pranë ASHK kanë marrë përsipër përpunimin e praktikës, me qëllim përfundimin brenda afatit, meqenëse ishte voluminoze, por për arsye ngarkese nuk kishte arritur që të bënte plotësimin e saktë të regjistrimit fillestar të pasurive të krijuara nga kontratat e sipërmarrjes, në emër të subjektit investitor ndërtues "..." sh.p.k. Sipas saj, plotësimin e saktë dhe përfundimtar të regjistrimit e kishte lënë që ta bënte në fundjave, në datat 21 dhe 22 Shtator. Më tej ajo ka deklaruar se certifikatat e para në favor të subjektit ndërtues, në bazë të së cilave ishin bërë transaksione me të tretët, ishin lëshuar nga juristët e tjerë që kanë punuar më pas me këto pasuri, duke qenë se kjo shtetase nuk kishte akses në sistemin IPS, pasi nuk kishte asnjë aplikim të kaluar, sikurse nuk ka qenë ajo që ti ketë dërguar drejtuesit këtë praktikë. Kjo shtetase ka sqaruar se verifikimin përfundimtar të praktikës e bën drejtuesi, i cili në rast se konstaton se probleme nuk i firmos certifikatat dhe i kthen për rishikim".

16. Shtetasi "..." , përfaqësues i subjektit ndërtues "..." sh.p.k, në Procesverbalin e pyetjes si person që tregon rrethana të hetimit, ka deklaruar se ai nuk ishte pajisur me kartelat e pasurive, pavarësisht se kishte kryer aplikimin dhe pagesën për të gjitha shërbimet: Kartelë Pasurie, Certifikata e Pronësisë dhe Hartë Treguese, për disa pasuri. Sipas deklarimit të tij, shoqëria ka paraqitur edhe një deklaratë ku shprehet vullneti për vendosjen e kufizimeve në lidhje me pasuritë e individualizuara të pronarëve. Ky shtetas ka sqaruar se ka qenë ai që ka tërhequr certifikatat dhe i ka marrë dorazi tek ASHK-ja, nga punonjësja e ASHK-së që quhet "..."

17. Ka rezultuar se Drejtuesi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës nuk ka nënshkruar dhe vulosur volumin fizik të regjistrimit të pasurive. Pavarësisht mangësive në të dhënat si më sipër, u provua se për disa pasuri janë lëshuar Certifikatat e Pronësisë datë 15.07.2019, të nënshkruara nga ana e drejtuesit shtetasi "..." dhe janë kryer transaksione midis



shoqërisë " " sh.p.k me të tretë, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës prej tij, si Drejtori i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, konkretisht:
 Kontrata shitblerje Nr. Rep dhe Nr. Kol, datë .08.2019 për pasurinë nr. , vol. , fq. , ZK , Kontratë shitblerje Nr. Rep dhe Nr. Kol, datë .08.2019, për pasurinë nr. , vol. , fq. , ZK , Kontrata shitblerje Nr. Rep dhe Nr. Kol, datë .08.2019 për pasurinë nr. vol. , fq. , ZK , Kontratë shitblerje Nr. Rep dhe Nr. Kol, datë .09.2019 për pasurinë nr. , vol. , fq. , ZK , Kontratë shitblerje Nr. Rep dhe Nr. Kol, datë .09.2019 për pasurinë nr. , vol. , fq. , ZK , Kontratë shitblerje Nr. Rep dhe Nr. Kol, datë .08.2019 për pasurinë nr. , vol. , fq. , ZK e pasurinë nr. , vol. , fq. , ZK , Kontratë shitblerje Nr. Rep dhe Nr. Kol, datë .09.2019 për pasurinë nr. , vol. , fq. , ZK , Kontratë shitblerje nr. Rep dhe Nr. Kol, datë .08.2019 për pasurinë nr. , vol. , fq. , ZK Kontratë shitblerje nr. Rep dhe Nr. Kol, datë .08.2019 për pasurinë nr. , vol. , fq. , ZK Kontratë për shitje me rezervë Nr. Rep dhe nr. Kol, datë .08.2019 për pasurinë nr. , vol. , fq. , ZK

18. Në kushtet kur prej shtetasit nuk janë kryer verifikimet e domosdoshme të gjithë praktikës së ndjekur, në kushtet kur për disa pasuri janë lëshuar Certifikatat e Pronësisë dhe janë kryer transaksione, në kundërshtim me Ligjin 111/2018 "Për Kadastrën" dhe aktet nënligjore, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg", ndaj këtij shtetasi, si person që dyshohet se ka kryer veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", neni 248 i K.Penal (Urdhër për Regjistrimin e Emrit të Personit që i Atribuohet Vepra, datë 30.09.2019).

19. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me Vendimin nr , datë 01.10.2019 ka vendosur: "1. Caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit , si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 Kodit Penal. 2. Urdhërohet Prokuroria dhe Policia Gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi. 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 5 ditëve në Gjykatë e Apelit Durrës". Në zbatim të këtij vendimi, më datë 01.10.2019 është nxjerrë Urdhri i Ekzekutimit dhe zbatimi i tij është kryer nga oficeri i policisë gjyqësore më datë 01.10.2019, ora 15.30, sipas Procesverbalit për Ekzekutimin e Urdhrit Nr. Për Ekzekutimin e vendimit penal.

20. Sa më sipër Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesën me objekt si në hyrje të këtij vendimi.

II. Analiza juridike.

21. Gjykata si verifikoi identitetin e personit të arrestuar , i datëlindjes 04.1983, dëgjoi kërkesën e organit të akuzës dhe provat bashkëlidhur saj, si dhe shqyrtoi kushtet dhe kriteret e masës së sigurimit "Arrest në burg", konkludoi se kjo masë sigurimi i përgjigjej nevojave të sigurimit në rastin konkret dhe nuk ekzistonin kushte për revokimin apo zëvendësimin e saj.



22. Në këtë konkluzion Gjykata arriti duke mbajtur në konsideratë nenin 228 të K.Pr.Penale, i cili parashikon se: "1. Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. 2. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së veprës penale ose dënimit. 3. Masat e sigurimit personal vendosen: a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet".

23. Në interpretimin të dispozitës së sipërcituar, rezulton se kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të caktuar një masë sigurimi personal, janë:

- Së pari, të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen e një vepre penale;
- Së dyti, të mos ekzistojnë shkaqe padënueshmërie ose shuarje të veprës penale apo dënimit;
- Së treti, duhet të plotësohet njëri prej kushteve të veçanta, ekzistenca e shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; i pandehuri të jetë larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; ose rreziku që për shkak të personalitetit i pandehuri mund të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

24. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi mund të ketë kryer veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Gjykata mban në vëmendje Vendimin Unifikues penal nr. 7 dt. 14.10.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në të cilin është mbajtur qëndrimi se në caktimin e masave të sigurimit personal njafort dyshimi i arsyeshëm se personi ka kryer veprë penale dhe jo bindja përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në rastin konkret, në vlerësimin e Gjykatës ky kusht konsiderohet i plotësuar, pasi nga provat e paraqitura për personin nën hetim, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se ai mund të ketë kryer veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

25. Gjykata çmon se, për sa i përket veprës penale "Shpërdorimi i Detyrës", neni 248 i K.Penal, objekt i kësaj vepre penale, janë ato marrëdhënie juridike të vendosura me ligj të cilat sigurojnë veprimtarinë e rregullt e normale të aparatit shtetëror, institucioneve, të shërbimeve publike, si dhe mbrojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve dhe të shtetit. Në këtë kuptim, neni 248 i K.Penal, i sipërcituar është një dispozitë "blanket" e cila i referohet akteve të tjera që normojnë punën e personit që ushtron funksione publike, ku në rastin konkret është Ligji 111/2018 "Për Kadastrën" dhe aktet nënligjore si Udhëzimi nr.1, datë 13.04.2016 "Për Caktimin e Kriterëve e të Procedurave Për Regjistrimin e Lejes së Ndërtimit dhe Akteve Noteriale, Të Lidhura Për Zhvillimin, në Cilësinë e Investitorit e të Pronarëve të Trullit apo Blerësve të Njësive" dhe Rregulloret e brendshme të institucionit. Për sa i përket anës objektive vepra penale e shpërdorimit të detyrës kryhet me veprime aktive të kundraligjshme ose duke mos kryer veprime të caktuara në kundërshtim me ligjin, që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës, të cilat të kenë sjellë si pasojë përfitime materiale ose jomateriale për vetë kryerësin ose



100/100 AN
30/01/2018

për persona të tjerë ose të kenë dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë. Subjekti është i posaçëm, person që ushtron një detyrë shtetërore apo shërbim publik, i cili duhet të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale e të jetë i përgjegjshëm dhe nga ana subjektive, vepra të kryhet me dashje.

26. Në Ligjin për Kadastrën, në dispozitat kalimtare të tij, neni 72/1/2 është parashikuar se: "Ligji nr.33/2012, datë 21.3.2012, "Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme", i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë në ndonjë ligj tjetër që bie ndesh me këtë ligj, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji. 2. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit "Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme" qëndrojnë në fuqi dhe zbatohen, për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji, deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore". Gjykata vlerëson se aktet nënligjore si Udhëzimi nr.1/2016 "Për Caktimin e Kriterëve e të Procedurave Për Regjistrimin e Lefjes së Ndërtimit dhe Akteve Noteriale, Të Lidhura Për Zhvillimin, në Cilësinë e Investitorit e të Pronarëve të Truallit apo Blerësve të Njësive", Rregullorja e brendshme e ish ZVRPP, nr.184, datë 08.04.1999 (e ndryshuar) si dhe Rregullorja e Brendshme për funksionimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Nr.8682 Prot, datë 30.12.2016, pavarësisht hyrjes në fuqi të Ligjit për Kadastrën, janë të zbatueshme pasi nuk bien në kundërshtim me të. Për sa kohë Ligji 111/2018 nuk ka asnjë rregullim specifik si për detyrat funksionale të drejtuesit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës apo edhe të punonjësve të tjerë pranë ASHK-së, në lidhje me procedurën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, atëherë Gjykata vlerëson se nuk ka kundërshtim midis tyre, janë plotësuese të njëra tjetrës, e si rrjedhojë janë të zbatueshme.

27. Nga provat e paraqitura si: Proces-verbal për sekuestrimin e sendeve, datë 20.09.2019; Procesverbal për kqyrjen datë 20.09.2019, Procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 20.09.2019, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, si dhe pyetja e personit të arrestuar në seancë, Gjykata konkludon se ka një dyshim të arsyeshëm që nga ana e tij të jenë kryer veprime/mosveprime në kundërshtim me ligjin, të cilat kanë cenuar veprimtarinë e rregullt e normale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës.

28. Ekziston një dyshim i arsyeshëm që personi nën hetim **** të mos ketë zbatuar legjislacionin përkatës që rregullon veprimtarinë e institucionit që ai drejton, në lidhje me praktikën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të regjistruara në volumet e regjistrit **** të Katundit ****, ZK ****. Kështu, në nenin 10/5 të Ligjit 111/2018 "Për Kadastrën", parashikohet se: "Drejtori i drejtorisë vendore është autoriteti që lëshon akte kadastrale për çdo pasuri që gjendet në juridiksionin territorial të drejtorisë dhe nxjerr aktet në zbatim të legjislacionit për çështjet e pronësisë". Duke qenë titullar i institucionit dhe referuar dispozitës së cituar, drejtuesi i ASHK-së në nivel vendor ka detyrim ligjor që të nxjerrë akte, përfshirë këtu Certifikatat e Pronësisë, në përputhje me legjislacionin për çështjet e pronësisë, ligje apo akte nënligjore.



29. Drejtuesi, sipas parashikimit ligjor ka detyrimin që të kontrollojë nëse është zbatuar procedura ligjore, nëse një praktikë është përfunduar plotësisht dhe në përputhje me ligjin apo aktet nënligjore dhe më pas të lëshojë certifikatat apo aktet e tjera kadastrale. Ky parashikim, për sa i përket procesit të verifikimit që duhet të kryejë titullari i institucionit para përfundimit të regjistrimit dhe para lëshimit të akteve gjendet në pikën 6 të Rregullores së brendshme të ish ZVRPP, nr.184, datë 08.04.1999 (ndryshuar), sipas së cilës: "1. Regjistruesi është përgjegjës për veprimtarinë e ZRPP...3. Regjistruesi fillon dhe ndjek regjistrimin e parë të pasurive të paluajtshme deri në përfundimin e tij. 4. Lëshon certifikatë pronësie, qiraje apo të interesave të tjera, të regjistruara në KPP, subjektit që e kërkon dhe që i takon ta kërkojë...8. Refuzon një regjistrim kur nuk janë të plota dokumentat e pronësisë, qirasë etj si dhe nëse nuk janë kryer veprimet që kërkohen sipas ligjit për RPP. 9. Administron dokumentat dhe bëjnë verifikimin e tyre".

30. Rregullorja e Brendshme për funksionimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Nr.8682 Prot, datë 30.12.2016 gjithashtu, në nenin 65 të saj "Detyrat e Regjistruesit", parashikon: a) Regjistruesi ushtron këto detyra kryesore: a) drejton dhe organizon veprimtarinë e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për realizimin e funksioneve dhe përmbushjen e detyrave të saj, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi; b) përgjigjet dhe raporton përpara Kryeregjistruesit veprimtarinë e Zyrës Vendore; c) t'i lëshojë personit të interesuar që ka të drejtën të kërkojë, certifikatë pronësie, qiraje apo të interesave të tjera të regjistruara në kartelë mbi pasurinë e paluajtshme; ç) të kërkojë me shkrim ose me shkresë zyrtare nga personi i interesuar që brenda një afati jo më të gjatë se 30 dite, të paraqesë dokumentet e pronësisë, certifikata, çdo dokument tjetër apo plan rievimi, të lidhur me pasurinë e paluajtshme, kontratën e qirasë ose hipotekën në fjalë. Në rast të mosparaqitjes së dokumentit të kërkuar brenda afatit të sipërcituar kërkesa për regjistrim refuzohet; d) të thërrasë çdo person të interesuar që të paraqitet tek ai ose ndonjë person tjetër autorizuar prej tij për të dhënë informacion ose shpjegim për pasurinë e paluajtshme, kontratën e qirasë ose hipotekën; dh) t'i propozojë Kryeregjistruesit refuzimin e regjistrimit kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë ligj; e) të administrojë dhe të verifikojë të dhënat e përcaktuara në shkronjat, "c", "ç", "d", "dh" të këtij neni; ë) t'i kërkojë personit që paraqet një informacion jo të rregullt që t'ia paguajë zyrës së regjistrimit shpenzimet që ajo ka kryer në procesin e verifikimit të këtij informacioni jo të rregullt; g) bashkërendon punën brenda zyrës së regjistrimit për të siguruar një bashkëpunim korrekt me institucionet shtetërore për të shkëmbyer informacionin e nevojshëm për të drejtat e regjistruara në regjistrat e pasurive të paluajtshme, si dhe për përmbushjen e detyrave të tij, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; gj) marrjen e masave organizative për rritjen e cilësisë së shërbimit në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

31. Ndërkohë në Udhëzimin nr.1, datë 13.04.2016, për Regjistrimin përfundimtar të ndërtimeve të reja, në pikën 24, dokumentacioni ligjor i domosdoshëm përcaktohet si më poshtë: "a) Leja e zhvillimit; b) Leja e ndërtimit (e detyrueshme për lejet e dhëna në zbatim të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, "Për urbanistikën"); c) Procesverbal i kolaudimit; ç) Plan i vendosjes së objektit; d) Dokumente të tjera, që individualizojnë njësitë e objektit të ndërtuar (projekti, planimetritë e kateve etj.); dh) Aktet noteriale dhe aktet e tjera të porosisë dhe sipërmarrjes, të lidhura para noterit, ndërmjet porositësve dhe subjektit të përcaktuar si



investitor në lejen e ndërtimit, të paraqitura nga subjektet e interesuara, nëse ka; e) Kontratat noteriale të sipërmarrjes dhe marrëveshje të tjera noteriale, të lidhura ndërmjet pronarëve të truallit dhe investitorit, nëse ka; ë) Certifikata e përdorimit.

32. Në interpretim të dispozitave ligjore të mësipërme, Gjykata konkludon se Drejtori i ASHK-së ka detyrim ligjor të krvejë të gjitha verifikimet sa i përket dokumentacionit teknik-ligjor të një praktike dhe veprimtarisë së specialistëve për atë praktikë, para nënshkrimit të saj si të përfunduar. Në të kundërt, si hallka e fundit e gjithë procesit, drejtuesi këtij institucioni nëse gjen të paplotë praktikën procedon me propozim për refuzim, refuzim, ose bashkërendimin e punës deri në plotësimin në mënyrë të rregullt të praktikës së regjistrimit të një pasurie.

33. Për sa i përket anës objektive, në rastin konkret ka dyshime se personi nën hetim, me veprime ose mosveprime ka konsumuar veprën penale "Shpërdorim i detyrës", pasi nuk ka kryer verifikime të plota të së gjithë praktikës së regjistrimit të pasurisë, përputhshmërisë së regjistrimit fizik me atë elektronik. Nga provat e shkrësore dhe deklaratimet e personit të arrestuar rezultoi se regjistrat fizikë nuk janë të nënshkruara nga specialisti jurist që ka përpiluar praktikën, madje në shumë fletë nuk rezultoi i shënuar emri i juristit që e ka bërë përpunimin e praktikës. Është konstatuar gjithashtu se nga ana e drejtuesit të institucionit nuk është bërë nënshkrimi dhe vulosja e regjistrimit fizik. Ka rezultuar që praktika të mos figurojë e përfunduar as në sistemin elektronik. Pavarësisht mangësive si më sipër, janë lëshuar disa Certifikata dhe Kartela të pasurive, pjesë e vol. ... të Katundit ..., në kundërshtim me nenin 50 e 51 të Ligjit 111/2018 "Për Kadastrën" (në të cilën parashikohet procedura e regjistrimit të kontratave të sipërmarrjes dhe procedura e regjistrimit përfundimtar të një ndërtimi të ri) dhe pikën IV të Udhëzimit nr.1/2016 "Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja".

34. Në vijim, në Udhëzimin nr.1, datë 13.04.2016 "Për Caktimin e Kritereve e të Procedurave Për Regjistrimin e Lejes së Ndërtimit dhe Akteve Noteriale, Të Lidhura Për Zhvillimin, në Cilësinë e Investitorit e të Pronarëve të Truallit apo Blerësve të Njësive", në pikën 26.2 gjendet ky parashikim: "Kur ka akt noterial të lidhur ndërmjet pronarit të truallit dhe investitorit, i cili përcakton përqindjen që do të përfitojë pronari i truallit në objekt, por nuk individualizon pasuritë që do të përfitojë ky i fundit nga marrëveshja me investitorin, ky akt do të evidentohet në seksionin përkatës të regjistrimit/kartelës të të gjitha njësive të individualizuara, të mbetura në emër të investitorit, të administruara nga ZRPP-ja, në momentin e dorëzimit të tij". Nga aktet e paraqitura në cilësinë e provës, të administruara në këtë gjykim nuk rezultoi që pronarët e truallit të kenë lidhur me subjektin ndërtues kontratat përfundimtare, ku të jenë individualizuar pjesët takuese, fakt që provohet edhe nga shkresa Deklaratë, e shoqërisë ... sh.p.k, datë ... 06.2019, drejtuar ASHK Durrës, në të cilën pasqyrohet: "Deklarojmë se shoqëria ... sh.p.k ka aplikuar pranë ASHKD për regjistrim përfundimtar të objekteve të reja në bazë të Certifikatës së Përdorimit Nr. ... prot, datë ... 05.2019, lëshuar nga AZHT. Për këtë arsye kërkojmë vazhdimin e procedurave të regjistrimit të objekteve dhe kufizimin e veprimeve për pronarët e truallit në seksionin E, deri në realizimin e kontratës së shkëmbimit. Bashkëlidhur lista e objekteve të specifikuar për pronarët e truallit".

35. Duke u bazuar në parashikimin e cituar më lart, Gjykata vlerëson se, kontratat fillestare të lidhura midis pronarëve të truallit dhe subjektit ndërtues do të duheshin të pasqyroheshin në të gjitha pasuritë që i përkasin vol. ... Katundi ... ZK ... meqenëse nuk kanë



pasur të individualizuara njësitë konkrete për pronarët. Në rastin konkret, në aktet e paraqitura rezultoi që nuk janë pasqyruar sikurse përcakton udhëzimi.

36. Pavarësisht mangësive në të dhënat si më sipër, u provua se për disa pasuri janë lëshuar Certifikatat e Pronësisë, të nënshkruara nga ana e drejtuesit shtetasi *** dhe janë kryer transaksione me të tretë konkretisht: Kontrata shitblerje Nr. *** Rep dhe Nr. *** Kol, datë ***.08.2019 për pasurinë nr. *** , vol. *** , fq.*** , ZK *** , Kontratë shitblerje Nr. *** Rep dhe Nr. *** Kol, datë ***.08.2019, për pasurinë nr. *** , vol. *** , fq. *** ZK *** Kontrata shitblerje Nr. *** Rep dhe Nr. *** Kol, datë ***.08.2019 për pasurinë nr. *** , vol. *** , fq. *** , ZK *** Kontratë shitblerje Nr. *** Rep dhe Nr. *** Kol, datë ***.09.2019 për pasurinë nr. *** , vol. *** , fq. *** ZK *** Kontratë shitblerje Nr. *** Rep dhe Nr. *** Kol, datë ***.09.2019 për pasurinë nr. *** , vol. *** , fq. *** ZK *** Kontratë shitblerje Nr. *** Rep dhe Nr. *** Kol, datë ***.08.2019 për pasurinë nr. *** , vol. *** , fq. *** ZK *** e pasurinë nr. *** , vol. *** , fq. *** ZK *** Kontratë shitblerje Nr. *** Rep dhe Nr. *** Kol, datë ***.09.2019 për pasurinë nr. *** , vol. *** , fq. *** ZK *** Kontratë shitblerje nr. *** Rep dhe Nr. *** Kol, datë ***.08.2019 për pasurinë nr. *** , vol. *** , fq. *** , ZK *** Kontratë shitblerje nr. *** Rep dhe nr. *** Kol, datë ***.08.2019 për pasurinë nr. *** , vol. *** , fq. *** ZK *** Kontratë për shitje me rezervë Nr. *** Rep dhe nr. *** Kol, datë ***.08.2019 për pasurinë nr. *** , vol. *** , fq. *** ZK ***

37. Gjykata çmon se personi nën hetim është subjekt i posaçëm pasi ka qenë në ushtrimin e një detyre shtetërore, ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm. Ndërsa në lidhje me anën subjektive, ka një dyshim të arsyeshëm, që vepra penale të jetë kryer me dashje dhe që mund të kenë ardhur pasoja në dëm të personave fizikë apo juridikë, kryesisht të pronarët e truallit, por edhe tek ndërtesat. Së pari pasi u provua se për këto pasuri të paluajtshme kanë nisur transaksionet midis shoqërisë " *** " sh.p.k dhe të tretëve, pa u individualizuar më parë pjesa takuese e pronarëve të truallit. Së dyti, u provua se shoqëria tregtare " *** " sh.p.k kishte kryer aplikimin dhe pagesën për të gjitha shërbimet: Kartelë Pasurie, Certifikata e Pronësisë dhe Hartë Treguese, por ndërkohë nuk e ka përfituar atë të plotë.

38. Gjykata, për sa i përket pretendimeve të personit nën hetim, në lidhje me natyrën e përgjegjësisë në rastin konkret apo rrethanave të ndryshme që mund të jetë penguar në ushtrimin e detyrës së tij si, mungesa e kohës fizike, praktika voluminoze, periudha e pushimeve, apo problemeve teknike, vlerëson se këto pretendime nuk përbëjnë shkak për të justifikuar kryerjen e detyrës në kundërshtim me ligjin. Sikurse vlerëson se gjithsesi këto pretendime do të nënshtrohen procesit të provueshmërisë në një fazë më të vonshme të procedimit. Kjo pasi sikurse u theksua edhe më lart, në caktimin e masave të sigurimit personal, mjafton dyshimi i arsyeshëm se personi ka kryer vepër penale dhe jo bindja përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

39. Nga rrethanat e faktit, Gjykata vlerëson se nuk ekziston ndonjë shkak padënueshmërie, shuarje të veprës penale apo dënimit, siç janë mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, ushtrimi i një të drejtë, falja, amnistia etj. Prandaj në kuptim të ligjit Gjykata e konsideron edhe këtë kusht të plotësuar.



40. Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:

- a) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
- b) largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;
- c) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

41. Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit "..." është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3 gërma "a" dhe "b" e Kodit të Procedurës Penale. Në këtë mënyrë, për shkak të rëndësisë të veprës penale dhe sanksionit që parashikon K.Penal për veprën penale "Shpërdorim i detyrës", neni 248, burgim deri në 7 vjet, vepër për të cilën shtetasi "..." dyshohet se e ka kryer, çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi për vendosjen e një mase sigurimi pasi ekziston rreziku që i dyshuari të largohet për t'ju shmangur hetimit. Në vijim Gjykata çmon se, meqenëse ushtrimi i detyrës së të dyshuarit ka lidhje me veprimet ose mosveprimet e tij si subjekt i posaçëm i veprës penale që parashikon neni 248 i K.Penal, ka një rrezik real dhe nevojë për marrjen e një mase procedurale për të shmangur mundësinë që ka personi nën hetim "..." për të ndërhyrë në procesin e të provuarit nëpërmjet manipulimit të provave shpresore apo ndikimit në personat që mund të kenë dijeni për veprën penale, duke vlerësuar se hetimet për këtë procedim penal janë në fazë fillestare.

42. Si përfundim, duke qenë se plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e përgjithshme dhe dy nga kushtet e veçanta, Gjykata vlerëson se ekzistojnë konditat e nevojshme për caktimin e një mase sigurimi me karakter shtrëngues, ndaj personit nën hetim. Për caktimin e kësaj mase, bazuar në nenin 229 të K.Pr.Penale Gjykata merr parasysh nevojat e sigurimit në rastin konkret, rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrezikshmërinë e personit nën hetim, sanksionin që parashikohet nga ligji për veprën penale konkrete.

43. Vepra penale për të cilën dyshohet personi nën hetim, paraqet rrezikshmëri të theksuar shoqërore pasi cenon marrëdhënie juridike të rëndësishme të mbrojtura posaçërisht nga ligji penal. Rrezikshmëria e personit nën hetim shihet kryesisht në raport me rrezikshmërinë e veprës, por edhe me personalitetin e tij. Mënyra e kryerjes së veprës penale, fakti që ende aktualisht rezultojnë që personi nën hetim mban qëndrimin mohues ndaj veprës penale, janë elemente që vërtetojnë rrezikshmërinë e personit nën hetim. Shtetasi i arrestuar paraqet një rrezikshmëri të tillë shoqërore sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet të vijojë masa e "Arrestit në burg". Për të dyshuarin "..." për shkak të veprës penale për të cilën dyshohet ekziston një rrezik i mundshëm që ai të largohet, apo të ndërhyjë në manipulimin e provave shpresore, të ndikojë në persona që mund të kenë dijeni për këtë vepër penale, nisur edhe nga cilësia e tij si Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Durrës.

44. Gjykata e gjen pretendimin e mbrojtjes të personit nën hetim, se ndaj tij duhet të revokohet masa e sigurimit e caktuar, si jo të bazuar në ligj dhe prova. Kjo pasi nga momenti i caktimit të masës deri në verifikimin e saj ka kaluar një kohë relativisht e ulët dhe nuk ka asnjë ndryshim të kushteve dhe kritereve apo rrethanave që janë marrë parasysh nga gjykata për



caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg". Siç u arsyetua edhe më sipër, kjo masë është tërësisht në përputhje me rëndësinë e faktit, rrezikshmërinë e veprës dhe autorit, marzhin e dënimit që parashikohet nga ligji për veprën penale për të cilën dyshohet i arrestuari. Në rrethanat konkrete për arsyet që u cituan më sipër, vetëm kjo masë mund të përmbush më së miri nevojat e sigurimit.

45. Sa më sipër Gjykata vlerëson se kërkesa e prokurorisë është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet, duke u caktuar masa e sigurimit "Arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale ndaj personit nën hetim i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të neneve 238 dhe 248 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI

1. Verifikimin dhe konstatimin e respektimit të kushteve dhe kritereve për zbatimin e masës shtrënguese "Arrest në burg" dhënë me vendimin penal Nr., datë 01.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndaj personit nën hetim
2. Personi nën hetim- mbetet me masë shtrënguese "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i Kodit Procedurës Penale.
3. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për veprim.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 5 ditëve nga e nesërmyja e shpalljes së tij.

U shpall në Durrës sot më datë 04 Tetor 2019.

GJYQTARE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Nr. Regjistrimit Themeltar ***
Nr. Vendimi ***

Datë Regjistrimi 30.09.2019
Datë Vendimi 01.10.2019

V E N D I M

“PËR CAKTIMIN MASËS SË SIGURIMIT”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e përbërë nga:

GJYQTARE: *****

Sot më datë 01.10.2019, i dha fund shqyrtimit gjyqësor, në dhomë këshillimi, të kërkesës që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, përfaqësuar nga Prokuror *****

KUNDËR: ***** i biri i ***** dhe ***** datëlindja ***** 04.1983, lindur dhe banues në Tiranë, Lagje “*****”, Pallati ***** Shk. ***** Ap. ***** me kombësi e shtetësi shqiptare, me arsim të lartë, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

DYSHUAR: Për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “Arrest i në burg”.

BAZA LIGJORE: Nenet 228, 229, 230, 232, 238, 244 të K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, si dhe provat bashkëlidhur,

VËREN:

I. Rrethanat e faktit dhe Procedura.

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka paraqitur pranë kësaj gjykate kërkesën për “Caktimin e masës së sigurimit shtrëngues “Arrest i në burg”, të parashikuar nga



neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

2. Gjykata përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj dhe prova të kërkesës penale, analizoi kryesisht juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje. Në bazë të neneve 3/2, 69, 74 dhe 76 të Kodit të Procedurës Penale (K.Pr.P), gjykata çmon se çështja objekt gjykimi bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të saj.

Nga studimi i akteve të procedimit penal rezultoi se, mbi bazën e informacioneve të marra në rrugë operative është marrë dijeni se në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Durrës ishte bërë regjistrimi fillestar i një numri të konsiderueshëm të pasurive të paluajtshme, në favor të subjektit investitor "....." shpk, në volumet e regjistrimit me numër të Katundit ; Zona Kadastrale, në kundërshtim me ligjin.

4. Nga kqyrja dhe sekuestrimi i dokumentacionit në A.Sh.K-në Durrës, ka rezultuar se ekzistojnë dy kontrata sipërmarrjeje në këtë praktikë regjistrimi: Kontrata e Sipërmarrjes nr. Rep dhe nr. Kol, datë05.2007 e hartuar përpara noterës publike dhe Kontrata e Sipërmarrjes me nr. Rep dhe nr. Kol, datë 05.2010 e hartuar përpara noterit publik lidhur midis subjektit ndërtues sh.p.k dhe pronarëve të truallit.

5. Nga sekuestrimi i tre volumeve me numra të katundit rezultoi se të gjitha shënimet e bëra për regjistrimin fillestar të këtyre pasurive nuk janë të nënshkuara nga specialisti jurist që ka përpiluar praktikën, madje në shumë fletë nuk rezultoi i shënuar emri i juristit që e ka bërë përpunimin e praktikës. Është konstatuar gjithashtu se nga ana e drejtuesit të institucionit nuk është bërë nënshkrimi dhe vulosja e regjistrimit fizik.

6. Nga verifikimi në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim fillestar të kësaj praktike rezultoi se mungojnë kontratat e sipërmarrjes me pjesët takuese të individualizuara të pronarëve të truallit, mbi bazën e të cilave do të mund të bëhej kufizimi i saktë i njësive në favor të tyre. Si rrjedhojë, referuar dispozitave ligjore të Ligjit për Kadastrën, duhej të ishte bërë dhe pasqyruar kufizimi i të gjitha pasurive të regjistruara në pronësi shoqërisë "....." sh.p.k, kufizim që nuk është pasqyruar.

7. Nga dosja që është marrë me cilësinë e provës dokument rezultoi se personi që ka bërë aplikimin në favor të shoqërisë, nuk ka paraqitur akt përfaqësimi ose tagër të dhënë nga shoqëria për kryerjen e këtyre aplikimeve.

8. Ndërkohë, pavarësisht mangësive të konstatuara në praktikën për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, mbi bazën e aplikimeve të ndryshme nga personi juridik "....." sh.p.k janë lëshuar certifikatat e pronësisë dhe janë kryer transaksione me persona të tretë, ku nga provat e paraqitura u evidentua se edhe në kartelat e pasurive për të cilat janë lëshuar certifikata e pronësisë nuk janë shënuar kufizimet përkatëse, sipas kontratave që janë lidhur me pronarët e truallit, kusht ky i kërkuar shprehimisht nga Ligji Për Kadastrën.

9. Nga pyetja e shtetasve e rezultoi se nuk ka shënime në sistemin e të dhënave I.P.S (sistemi elektronik) se



kjo praktikë është përfunduar sikurse dhe nga ana e subjekteve që u është caktuar kjo detyrë nuk ka asnjë dokument të shkruar, që të provojë se regjistrimi i praktikës është kryer plotësisht.

10. Rezulton se kjo praktikë është përpunuar nga shtetasja *****, e cila nuk e kishte të drejtën që të merrte përsipër përpunimin e praktikës së një regjistrimi fillestar, pasi ajo ishte me detyrën e përgjegjëses së sektorit juridik dhe bashkëqeverisjes në këtë zyrë. Shtetasja ***** ka deklaruar se për arsye ngarkese nuk kishte arritur që të bënte plotësimin e saktë të regjistrimit fillestar të pasurive të krijuara nga kontratat e sipërmarrjes, në emër të subjektit investitor ndërtues "*****" sh.p.k. Sipas saj, plotësimin e saktë dhe përfundimtar të regjistrimit e kishte lënë që ta bënte në fundjavë, në datat 21 dhe 22 Shtator. Më tej ajo ka deklaruar se certifikatat e para në favor të subjektit ndërtues, në bazë të së cilave ishin bërë transaksione me të tretët, ishin lëshuar nga juristët e tjerë që kanë punuar më pas me këto pasuri, duke qenë se kjo shtetase nuk kishte akses në sistemin IPS.

11. Shtetasi ***** përfaqësues i subjektit ndërtues "*****" sh.p.k, në Procesverbalin e pyetjes si person që tregon rrethana të hetimit, ka deklaruar se ai nuk ishte pajisur me kartelat e pasurive, pavarësisht se ai kishte kryer aplikimin dhe pagesën për të gjitha shërbimet: Kartelë Pasurie, Certifikata e Pronësisë dhe Hartë Treguese, për disa pasuri. Sipas deklarimit të tij, shoqëria ka paraqitur deklaratë dhe kërkesë për vendosjen e kufizimeve në lidhje me pasuritë e individualizuara të pronarëve, duke qenë në procesin e përfundimit të kontratave të shkëmbimit me pronarët e truallit.

12. Ka rezultuar se Drejtuesi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës nuk ka nënshkruar dhe vulosur volumnin fizik të regjistrimit të pasurive. Pavarësisht mangësive në të dhënat si më sipër, u provua se për disa pasuri janë lëshuar Certifikatat e Pronësisë, të nënshkruara nga ana e drejtuesit shtetasi ***** dhe janë kryer transaksione me të tretët.

13. Në kushtet kur prej shtetasit ***** nuk janë kryer verifikimet e domosdoshme të gjithë praktikës së ndjekur, në kushtet kur për disa pasuri janë lëshuar Certifikatat e Pronësisë në kundërshtim me Ligjin 111/2018 "Për Kadastrën" dhe aktet nënligjore, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesën me objektin se sipërcituar.

II. Analiza juridike.

a. Lidhur me caktimin e masës së sigurimit

14. Ligjvënësi ka parashikuar se masat e sigurimit personal që kufizojnë të drejtat dhe liritë e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal, mund të caktohen vetëm kur ekzistojnë dhe provohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj. Këto kushte dhe kriteret, të shpallura në nenin 5 të KEDNJ, janë materializuar edhe në nenin 27 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kështu, në nenin 27 të Kushtetutës, një ndër rastet se kur liria e personit mund të kufizohet, parashikohet edhe rasti kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprave penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj, të materializuara edhe në ligjin procedural penal, konkretisht në nenin 228 dhe 229 të K.Pr.Penale për masat e sigurimit në përgjithësi dhe në veçanti në nenin 230/1 për masën e sigurimit personal "Arrest në burg". Kështu në pikën 1 dhe 2 të nenit 228 të K.Pr.Penale,



sanksionohen kushtet e përgjithshme që duhet të mbajë parasysh gjykata në caktimin e masës së sigurimit dhe të cilën janë:

15. **Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, ose elementi provues.** Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova është kushti më i rëndësishëm që vlerësohet, pasi askush nuk mund t'i nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova. Kuptimi juridik procedural i kushtit të dyshimit të arsyeshëm ka gjetur trajtim gjerësisht në Jurisprudencën e GJEDNJ. Kështu, për herë të parë, në çështjen Fox, Cambell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar dt. 30.08.1990, GJEDNJ shprehet për dyshimin e arsyeshëm duke përcaktuar se elementë të domosdoshëm të tij janë ndershmëria dhe "bona fides". *Pasja e një dyshimi të arsyeshëm presupozon, ekzistencën e fakteve ose informacionit, që bind një vëzhgues objektiv, që personi në fjalë mund të ketë kryer një veprë.* Në çështjen Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt. 28.10.1994, kjo Gjykatë theksoi se ajo që nënkuptohej me *dyshim i arsyeshëm* varej nga rrethanat e një çështje të veçantë dhe nuk mund të gjykohej sipas standardeve të njëjta.

16. Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova sipas pikës 1 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, nënkupton që bëhet fjalë për ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit që i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë që jo vetëm se vepra penale është kryer por dhe në drejtim të mundësisë se kjo veprë penale është kryer nga personi ndaj të cilit do të vendoset masa e sigurimit, që do të thotë se kërkohet detyrimisht përgjegjësia e personit që akuzohet. Pra, Gjykata thekson se dyshimi konsiderohet i arsyeshëm nëse bazohet në fakte dhe në informacione të cilën krijojnë bindjen se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprave penale për të cilën ai akuzohet¹.

17. Dyshimi i arsyeshëm në aplikimin e një mase sigurimi duhet të mbështetet në ato prova, që duhet të jenë të tilla, që në atë gjendje në të cilën ato ndodhen, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprave penale në ngarkim të tij, por se kjo shkallë dyshimi nuk duhet të jetë ezauruese (*Vendimi Unifikues nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*). Në fazën e caktimit të masës së sigurimit natyrisht që nuk mund të pretendohet se ka prova të plota që të mund të vërtetojnë akuzën, por duhet të ketë aq prova sa të krijojnë bazën e nevojshmërisë për caktimin e masës së sigurimit.

18. **Ekzistenca e veprave penale.** Përveç dyshimit të arsyeshëm gjykata duhet të konstatojë nëse ekzistojnë dhe dy kushtet e tjera të përgjithshme. Kushti i dytë është ekzistenca e veprave penale ku kërkohet që fakti të jetë parashikuar nga ligji si veprë penale, apo vepra penale të mos jetë shuar për shkak parashkrimi të ndjekjes penale, ose për shkak të shfuqizimit të dispozitave penale, apo të mos jetë amnistuar, ose dënimi mos të jetë shuar.

19. **Ekzistenca e kushteve të dënueshmërisë sipas së drejtës penale.** Kushti i tretë i përgjithshëm është ekzistenca e shkaqeve të dënueshmërisë së personit ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit. Nuk mund të caktohet masë sigurimi ndaj një personi që nuk mund të merret si i pandehur, ose nuk mund të dënohet si p.sh. personi që nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi

¹ Shiko Vendimin Nr. 72, date 18.05.2011 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.



penale, apo personi që është i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore, kur jemi para mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale penale, apo kur veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

20. Këto tre kushte duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative, pasi në qoftë se mungon njëri prej tyre atëherë gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi ndaj personit. Duke i ballafaquar këto kushte me faktet e çështjes konkrete, Gjykata thekson për rastin konkret se: Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi ****, mund të ketë kryer veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky dyshim rezultoi i provuar nga administrimi i provave të paraqitura nga organi i prokurorisë dhe konkretisht: Proces-verbal për sekuestrimin e sendeve, datë 20.09.2019; Procesverbal për këqyrjen datë 20.09.2019, Procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 20.09.2019, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****, Procesverbal i pyetjes së personit që ka dijeni për rrethana të hetimit ****.

21. Sa sipër, Gjykata, duke pasur parasysh analizën juridike mbi shkallën se deri ku gjykata mund të analizojë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në rastin e caktimit të masave të sigurimit, si rrjedhojë edhe të provave, thekson se në rastin konkret këto prova janë të tilla që bëjnë të duket e mundshme ekzistenca e veprës penale për të cilën dyshohet shtetasi **** si dhe përgjegjësia e tij me këtë veprë penale. Pra, prej provave të sipërpërmendura, trajtuar përmbajtja e tyre edhe në paragrafin mbi faktet e çështjes, mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie fajësie për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij, duke theksuar se ky dyshim në këtë fazë nuk kërkohet dhe nuk mund të jetë kurrsesi ezaurues. Në këtë aspekt, baza kryesore është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për ekzistencën e veprës penale, me të gjithë elementët e saj pra, ekzistenca e fakteve kriminale pa të cilët, nuk mund të diskutohet për caktim mase sigurimi.

22. Gjithashtu gjykata konstaton faktin se vepra penale për të cilën dyshohet shtetasi **** nuk rezultoi të jenë shuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe nuk rezultoi që kjo veprë të jetë shfuqizuar apo të jetë amnistuar. Në këto kushte plotësohet edhe kushti i dytë ai i ekzistencës së veprës penale.

23. Në vështrim të kushtit të tretë, gjykata thekson se nuk ekzistojnë shkaqe për të cilat ky shtetas nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pasi i ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret 14 vjeç pasi vepra penale për të cilën ai dyshohet se ka kryer është krim (rezulton se ai është i datëlindjes 1983).

24. Gjithashtu nuk rezultoi që shtetasi **** të jetë i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tij mendore. Po ashtu, gjykata konstaton se nuk ndodhemi në rastin konkret as para



mbrojtjes së nevojshme apo nevojës ekstreme, heqjes dorë nga kryerja e veprave penale, apo se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyrë apo gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme.

25. Gjykata, thekson se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova, në ngarkim të së dyshuarit është vetëm kushti fillestar, paraparak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të hetuarit.

26. Kështu, Gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme duhet të verifikojë nëse ekziston dhe një nga kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3 i Kodit të Procedurës Penale, që janë:


- a) ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
- b) largimi i të pandehurit, ose rreziku që ai të largohet;
- c) rreziku që i pandehuri për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

27. Paraprakisht, Gjykata, thekson se kushtet e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit janë alternative dhe jo kumulative. Nëse në gjykim vërtetohet njëri prej tyre, gjykata nuk ka detyrim të hetojë dhe vërtetojë edhe ekzistencën apo mos ekzistencën e kushteve dhe kriterëve të tjera që sipas ligjit justifikojnë ose jo caktimin e masës së sigurimit dhe kufizimin e lirisë së të hetuarit.

28. Në mbështetje të sa më sipër, gjykata në rastin konkret konstaton se caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit është i nevojshëm pasi ekziston kushti i parashikuar në pikën 3 gërma "a" dhe "b" e Kodit të Procedurës Penale. Në këtë mënyrë, për shkak të rëndësisë të veprës penale dhe sanksionit që parashikon K.Penal për veprën penale "Shpërdorim i detyrës", neni 248, burgim deri në 7 vjet, vepër për të cilën shtetasi dyshohet se e ka kryer, çmohet se ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi për vendosjen e një mase sigurimi pasi ekziston rreziku që i dyshuari të largohet për t'ju shmangur hetimit. Në vijim Gjykata çmon se, meqenëse ushtrimi i detyrës së të dyshuarit ka lidhje me veprimet ose mosveprimet e tij si subjekt i posaçëm i veprës penale që parashikon neni 248 i K.Penal, ka një rrezik real dhe nevojë për marrjen e një mase procedurale për të shmangur mundësinë që ka personi nën hetim për të ndërthyrë në procesin e të provuarit nëpërmjet manipulimit të provave shkresore apo ndikimit në personat që mund të kenë dijeni për veprën penale, duke vlerësuar se hetimet për këtë procedim penal janë në fazë fillestare.

b. Lidhur me caktimin e llojit të masës së sigurimit.

29. Për caktimin e masave të sigurimit, gjykata, përveç ekzistencës së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të respektojë dhe kriteret e parashikuara nga nenet 229-230 të K.Pr.Penale. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: "1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete.



Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal¹.

30. Ndërsa në nenin 230/1 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg. Konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: *"Arrestit në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit"*.

31. Kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse i japin gjykatës diskrecion të gjerë për të vendosur, qartazi synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret. Nëse nuk ka shkaqe që e përjashtojnë autorin nga përgjegjësia penale, këto kritere imponojnë detyrimin e gjykatës për të bazuar vendimin, nga njëra anë, në dyshime të arsyeshme bazuar në prova mbi kryerjen e veprave penale prej tij dhe nga ana tjetër, në prova që përmbajnë aq elemente të mjaftueshëm, objektive e subjektive, mbi rrethanat e çështjes, të cilën tregojnë se ekziston gjendja e rrezikut dhe shkallën e rrezikut². Me qëllim përcaktimit të masës së sigurimit personal më të përshtatshme dhe efikase në përputhje me faktet e dhëna, Gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

32. Lidhur me masën e arrestit në burg që ka kërkuar prokurori, Gjykata çmon të marrë në analizë edhe paragrafin 1 të nenit 230 të K.Pr.Penale i cili parashikon se *"Arrestit në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprave penale dhe të pandehurit"*.

33. Gjykata, paraprakisht gjen me vend të theksojë se, kërkesa për të vendosur masën më të ashpër të sigurimit personal duhet domosdoshmërisht të shoqërohet nga një analizë ligjorofaktike e mbështetur në prova dhe argumente bindës, lidhur me personalitetin dhe rrezikshmërinë që ky person shfaq në jetën e tij sociale, duke zbatuar kërkesën ligjore të nenit 230 të K.Pr.Penale³.

34. Lidhur me ruajtjen e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së dënimit, Gjykata vlerëson se mbi shtetasin bie dyshimi se ka kryer veprën penale të: *"Shpërdorimi i detyrës"* parashikuar nga neni 248 K.Penal, për të cilën ligji ka përcaktuar një dënim me burgim deri në 7 vjet. Megjithatë, rrezikshmëria e veçantë e veprave penale duhet të analizohet rast pas rasti duke e ndërthurur edhe me rrezikshmërinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale. Në rastin konkret u arrit të provohet se shtetasi i arrestuar paraqet një rrezikshmëri të tillë shoqërore sa çdo masë tjetër sigurie do të ishte e papërshtatshme dhe duhet vendosur masa e "Arrestit në burg". Për të dyshuarin për shkak të veprës penale për të cilën dyshohet ekziston një rrezik i mundshëm që ai të largohet, apo të ndërhyjë në manipulimin e provave shkresore,

¹ Vendimi Unifikues Nr. 7, datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

² Referuar praktikës gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Vendim nr. 244, datë 04.11.2009, vendim nr.164, datë 01.07.2009, vendim nr. 139, datë 03.06.2009, vendim nr.2, datë10.02.2010, vendim nr.3, datë 17.02.2010.



të ndikojë në persona që mund të kenë dijeni për këtë vepër penale, nisur edhe nga cilësia e tij si Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Durrës. Gjykata, gjen me vend të theksojë se, masa e sigurimit personal nuk është dënim penal, që të përdoret si masë ndëshkimore, por ajo vendoset kur ekzistojnë të gjitha elementët objektivë dhe subjektivë të parashikuar nga nenet 228/1/2/3 germat "a", "b", "c", nenet 229/1/2 e 230/1 të K.Pr.Penale.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të neneve 112, 228, 229, 238 dhe 244 të Kodit të Procedurës Penale,

VËNDOSI

1. Caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit *****, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimit të detyrës", të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
2. Urdhërohet Prokuroria dhe Policia Gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 5 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës.

U shpall sot, në Durrës më datë 01 Tetor 2019.

GJYQTARE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
DURRËS

URDHËR

PËR REGJISTRIMIN E EMRIT PERSONIT QE I ATRIBUOHET VEPRA

Në Durrës, sot më datën: 30.09.2019.

Unë ****, Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi studiova aktet e procedimit penal nr: *** te vitit 2019.

KONSTATOVA:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës më datën: 22.09.2017, ka regjistruar procedimin penal nr: *** per veprën penale të "Shperdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Ky procedim është regjistruar mbi bazen e materialeve të e para hetimore të referuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, me shkresën nr: *** prot. date: *** 09.2019, të protokolluara me nr: *** prot. date: *** 09.2019 në Prokurorinë Prane Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nga keto materiale hetimore rezultojnë e provuar se:

Mbi bazen e informacioneve të marra në rrugë operative, është marrë dijeni se në Zyren e Agjensisë Shtetërore të Kadashtës Durrës ishte bërë regjistrimi fillestar i një numri të konsiderueshem pasurish në favor të subjektit investitor **** shpk, në volumet e regjistrimit me numer **** të Katundit ****, Zona Kadastrale ****.

Keto pasuri rridhnin nga kontrata sipermarrjeje me pronaret e truallit, por nuk ishin shenuar në regjistrat e lartpërmendur kufizimet e sipërfaqeve takuese të pronareve të truallit, një shkelje kjo sipas parashikimeve ligjore të ligjit për kadashtën, konkretisht nenet 50 dhe 51 të tij.

Pavaresisht regjistrimit fillestar pa u bërë përcaktimi i pjesëve takuese, dhe mosnenshkrimi i regjistrave ku behet regjistrimi këtyre pasurive nga specialisti jurist, dhe nga Drejtori i Agjensisë Shtetërore të Kadashtës Durrës dhe as nuk është vëlosur nga ky institucion, dhe pas regjistrimit fillestar mbi bazen e aplikimeve të ndryshme nga shoqëria janë bërë transaksione të tjera me persona të tretë.

Nisur nga sa më sipër është bërë kqyrje dhe sekuestrim dokumentacioni në Zyren e A.Sh.K-se Durrës, nga ku rezultojnë se janë dy kontrata sipermarrjeje në këtë praktikë regjistrimi, dhe përkatësisht kontrata e sipermarrjes nr: **** rep dhe nr: **** kol. date: **** 05.2007 e hartuar përpara noterës publike ****, dhe kontrata e sipermarrjes me nr: **** rep dhe nr: **** kol. date: **** 05.2010 e hartuar përpara noterit publik ****.



Nga sekuestrimi i tre volumeve me numra *** te katundit *** rezulton se te gjitha shenimet e bera per regjistrimin fillestar te ketyre pasurive, nuk jane te nenshkruara nga specialisti jurist qe ka perpiluar praktiken, shtetasja *** madje ne shume faqe nuk rezulton i shenuar fare emri i juristit qe e ka bere perpunimin e praktikës.

Njekohesisht edhe nga ana e Drejtorit te Institucionit nuk eshte bere nenshkrimi i regjistrimit dhe as vulosja e regjistrimit edhe pse kane kaluar dy muaj nga momenti i pajisjes me certificate dhe realizimit te regjistrimit fillestar te pasurive ne emer te shoqerise Ndertuese *** Sh.P.K.

Nga pyetja e shtetasve *** rezulton se nuk ka shenime ne sistemin e te dhenave I.P.S se kjo praktike eshte perfunduar dhe njekohesisht nga ana e atyre qe u eshte kaluar kjo detyre sipas sistemit nuk ka asnje dokument te shkruar.

Nga pikepamja e faktit rezulton se perpunimi i praktikës eshte bere nga ana e soecislites *** qe nuk eshte pjese e sektorit te perpunimit te praktikave te regjistrimit, por eshte pergjegjese ne nje sektor tjeter prane A.Sh.K.S-se Durres.

Nga vete dosja qe eshte marre me cilesine e proves dokument rezulton se as personi qe ka bere aplikimin ne favor te shoqerise, nuk ka ndonje akt perfaqesimi ose tages te dhene nga shoqeria per kryerjen e ketyre aplikimeve.

Njekohesisht ne lidhje me kete ceshtje vete shtetasja *** e pranon se ka bere ajo kete praktike dhe se nga pikepamja nuk mund te merret praktike per regjistrim pasi nuk ishte ne ate sektor dhe nuk e kishte detyre funksionale.

Nga ana tjeter ajo ka deklaruar se per arsye ngarkese nuk kishte arritur qe te bente plotesimin e sakte te regjistrimit ku ka bere regjistrimin per here te pare te pasurive te krijuara nga kontrata e sipermartjes ne emer te subjekti investitor ndertues, *** Sh.P.K. dhe plotesimin e sakte dhe perfundimtar te regjistrimit e kishte lene qe ta bente ne fundjave, pra ne data 21 dhe 22 shtator, nderkohe qe certificatekat e para ne favor te subjektit ndertues ishin leshuar si dhe ishin bere kalime tek te tete nga juristet e tjere qe kane punuar me pas ne lidhje me keto pasuri.

As ne kartelat e pasurive per te cilat eshte nenshkruar certificatekat e pronesise dhe as ne vete librat e mesiperme ku behet regjistrimi manualisht nuk ka te shenuar kutizime te kontratave te pasurise me pronaret e truallit, kusht ky i kerkuar shprehimisht nga Ligji Per Kadastrin ne nenin 51 te tij.

Nga pyetja e shtetasit *** perfaqesues i subjektit ndertues rezulton se ai nuk kishte marre kartelat e pasurise, por vetem certificatekat e pronesise dhe hartat treguese, edhe pse ne aplikimin e tij dhe ne pagimin e tarifave pr cdo sherbim, rezulton se ata kane paguar nje shume prej 1000 (nje mije) lekesh te reja per cdo karteles, per cdo pasuri, duke i shkaktuar dem ekonomik te drejteperdrejte shoqerise.

Nga vete verifikimi i kushteve ligjore rezulton e autoriteti qe ben leshimin e certificatekes duke e nenshkruar dhe me pas duke u vulosur eshte pikerisht Drejtori i A.Sh.K-se Durres.

Ai ka tagrat ligjore qe te mos e nenshkruaje nje certificate te printuar pas perfundimit te perpunimit te praktikës nga ana e juristit specialit dhe hartografit perkates, ne rastet kur nuk plotesohen kushtet ligjore.

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur per regjistrim fillestar te sekuestruar prane arkives se A.Sh.K-se Durres, rezulton se vete shoqeria ka paraqitur nje deklarate dhe



nje kerkese per vendosjen e kufizimeve ne lidhje me pasurite e individuaalizuara te pronareve te truallit, dhe ka theksuar se eshte ne procesin e perfundimit te kontratave te shkembimit me pronaret e truallit, pra ajo vete pranon se nuk e ka kryer kete proces te kerkuar shprehimisht nga neni 51 i Ligjit per Kadastren.

Njekohesisht ne praktiken e regjistrimit fillestar mungojne edhe kontratat e siper marrjes perkatese me pjeset takuese, te cilat jane dokumentet e vetme ligjore mbi bazen e te cilave mund te behet kufizim i sakte i njesive ne favor te pronareve. Ne kete rasti ne mungese te ketyre dokumenteve duhet te ishte bere kufizimi i te gjitha pasurive te regjistruara ne favor te subjektit *** Sh.P.K. per here te pare.

Vete kartela e pasurise qe eshte nje dokument qe pasqyron te dhenat e lidhura manulaisht ne sistem nga ana e punonjesve te pasurise dhe qe tregon te dhenat e prones, eshte pasqyrim digjital i te dhenave te hedhura me dore.

Duke qene e regjistri nuk ka qene i plotesuar rezulton se ato nuk jane prodhur dhe nuk i jane dorezuar subjektit. Nga ana tjeter ne baze te rregullores se ketij institucioni rezulton se Drejtori si autoriteti pergjegjes qe e kontrollon te gjitha praktiken, jurist me eksperience ne kete sektor, rezulton se me dashje direkte ka shmangur nje procedure ligjore te tille, pasi as nuk ka verifikuar fizikisht volumin e regjistrimit te pasurive dhe as nuk ka nenshkruar ate si dhe nuk eshte kaluar ne protokolli per tu vulosur, dhe as nuk ka pare fizikisht kartelen e pasurive, pasi nqs ato per shkak te pamundesise objektive te paraqitjes se volumeve do ti ishin paraqitur atij perpara se te nenshkruante certifikatat, ai do te verente se ne kartela nuk kishte kufizime per te gjitha pasurite ashtu sic e kerkon ligji, pasi mungonin kontratat e siper marrjes me njesi te individualizuara me vullnet perpara noterit nga te dy palet e kontrates, por vetem nje kerkese per kufizim, e njeanshme e subjekti ndertues *** Sh.P.K.

Ne keto kushte ndodhemi perpara shperdorimit te detyres nga ana e ketij shtetasi dhe ndaj tij duhet te caktohet nje mase sigurimi personal shteteguese e Arrestit me burg, pasi nje shkelje e tille e ligjit eshte e rende dhe sjell pasoja ne drejtim te interesave pasurore te pronareve te truallit ne keto kontrata siper marrjeje te lartepremendura.

Sa me sipër, në mbështetje të nenit 287/1, 315/3, të K.Pr.Penale

URDHËROJ:

1. Të behet shenimi ne regjister i emrit qe i atribuohet vepra penale shtetasit: **** i biri i **** dhe i ****, i datelindjes: ****.04.1983, lindur dhe banues ne Tirane, Rruga " **** ". Pallati nr: ****, Shkalla nr: **** Apartamenti ****, Bashkia Tirane, gjinia mashkull, kombësia shqiptare, shtetësia shqiptare, me arsim te larte dega Filozofi dhe Drejtësi, me gjendje civile i martuar me dy femije, me gjendje gjyqesore i padenuar me pare, i identifikuar me karten e identitetit me numer ****, me numer telefoni ****, i dyshuar per kryerjen e veprës penale të "Shperdorimit te detyres" parashikuar nga neni 248 i K.Penal.
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Zyra e Regjistrimit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.

PROKURORI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PAJISË GJYKATES SE SHKALLËS SE PARË DURRES

UDHEZIM

(Me karakter lo te detyrueshem ne ceshfien penale nr. viti 2019)

Ne Dures, me 30/09/2019, une Anita Jella, me detyre Drejtues i Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Dures, pasi u njoha me aktet e ceshfjes datë 22.09.2019, për veprën penale "Shpërdorimi i detyres" të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ne ngarkim te shtetases

KONSTATOVA

Me date 22.09.2019, Prokuroria prane Gjykates se shkalles se pare Dures, ka regjistruar procedimin e mesiperme penal, ne ngarkim te shtetases, e cila dyshohet se ne kundërshtim me nenin 50, 51 e vijues te Ligjit nr. 111/2018, "Per Kadasren", ka bere regjistrimin fillestar te nje numri te konsiderueshem pasurish ne favor te subjektit investitor "..." shpk, ne volumet e regjistrimit nr. te Katundit, Zona Kadastrale nr. Keto pasuri rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes me pronaret e truallit, por nuk ishin shenuar ne regjistrat e lartpermendur kufizimit e sipërfaqeve takuese te pronareve te truallit. Te gjitha shenimet e bera ne regjistrimin fillestar te ketyre pasurive, nuk jane te nenshkrumra nga specialisti jurist qe ka perpluar praktiken, shtetasja Nga ana tjeter shtetasja nuk kishte te drejte te perpunonte praktikat e regjistrimeve te mesiperme, pasi ajo ishte me detyren e pergjegjeses se sektorit juridik dhe bashkeqeverisjes. Edhe nga shenimet ne sistemin I.P.S., nuk rezulton qe ajo te kete pasar dosjet e mesiperme ne perpunim, nderkohe qe veto kjo e fundit ka pranuar qe ka perpunuar keto praktika.

Kjo shtetase eshte ndaluar me Urdher te prokurorit te ceshfjes dhe me pas me vendimin nr. dt. 09.2019, te Gjykates se shkalles se pare Dures, eshte vendosur vlefesimi i ligjshem i ndalimit dhe caktimi i mases se sigurimit "Detyrim per tu paraqitur perpara o.p.gj si dhe pezullimi i ushtrimit te nje detyre a sherbimi publik", te parashikuara nga nenet 234 dhe 242 te K. Pr. Penale.

Me pas me date 26.09.2019, nga ana e prokurorit te ceshfjes eshte hartuar kerkese per caktimin e mases se sigurimit personal "arrest ne burg", ndaj shtetasit me detyre drejtori i Kadastres Shteterore Dures, me arsyetimin se ka nenshtruar pa u plotesuar kushtet ligjore, certifikatat e printuara pas perfundimit te praktikës nga ana juristit specialist dhe hartografit. Drejtori i ASHK, eshte autoriteti pergjegjes qe kontrollon te gjithë praktikën, jurist me eksperience ne kete sektor, rezulton se medashje direkte ka shmangur nje procedure ligjore te tille.

Nga studimi i akteve te dosjes penale nr. *** datë 22.09.2019, për veprën penale "Shpërdorimi i detyres" të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ne ngarkim te shtetases *** rezulton se nuk eshte regjistruar si autor i veprës penale emri i shtetasit ***

dhe ne keto kushte nuk mund te kerkohet caktim mase sigurimi pa regjistruar me pare emrin e autorit. Se dyti nga studimi i akteve rezulton se ka nevojë per kryerjen e veprimeve hetimore shtese me qellim administrimin e akteve e provave te plota qe te perbushet standarti i "dyshimit te arsyeshem" me qellim vendosjen e mases se sigurimit personal. Se fundi: rezulton se prane kesij prokurorie jane ne hetim edhe disa ceshjte te tjera penale qe kane te bejne me punen e A.K.Sh. Durres, ku jane kryer edhe hetime proaktive dhe provat e ketyre ceshjteve mund te ndikojne tek njera-tjetra.


Per sa me sipar dhe bazuar ne nenin 43/q dhe 48 te Ligjit Nr. 97/2016 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise", si dhe nenet 24, 25, e vijues te K.Pr.Penale,

URDHEZOJ:

1. Te regjistrohet emri i autorit *** me detyre drejtori i Kadastros Shteterore Durres.
2. Te merren dhe te administrohen akte te tjera hetimore me qellim qe te perbushet standarti i "dyshimit te arsyeshem" me qellim vendosjen e mases se sigurimit personal.
3. Te koordinohet puna edhe me prokuroret e tjere te cilet kane nen hetim procedime penale per punonjesit e A.S.H.K-sw me qellim administrimin e provave te tjera si dhe mosdenimin e hetimeve te ketyre ceshjteve te tjera ne hetim, ose bashkimin e tyre ne njw procedim penal.
4. Ky Udhëzim nuk eshte i detyrueshem per prokurorin e ceshjtës.
5. Nese prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi fidhur me kete udhëzim, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtajshme.
6. Në rast se prokurori, vendos të mos e nejjekë kete Udhëzim, njofton me shkrim drejtuesin e prokurorisë apo drejtuesin e seksionit, sipas rastit.
7. Udhëzimi me shkrim dhe përrjegjet e mundshme me shkrim të prokurorit i bashkëngjiten akteve të procedimit.

DREJTUESI I PROKURORISE

ANITA JELICA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
DURRES

Nr. ____ .prot (____)

Durrës, me: 26.09.2019

LENDË: Dergojme kerkese per caktim mase sigurimi.

DREJTUAR: Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres
Gjyqtares se hetimëve paraprake
Znj. _____

Bashkelidhur kesaj shkrese po ju dergojme kerkesen per caktimin e mases personale shtrenguese ne lidhje me procedimin penal nr: ____ te vitit 2019, te regjistruar per kryerjen e vepres penale te "Shperdorimit te detyres", parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Duke ju falenderuar per mirekuptimin!

DREJTUESI I PROKURORISE


ANITA JELLA



30.09.2019
Dre 11.2



International Monitoring Operation
*Project for the Support to the Process of Temporary
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania*



Funded by the European Union

International Monitoring Operation
Prot. No. 1252
Date. 14 / 11 / 2019

Tirana, 14 November 2019

To the
Independent Qualification Commission
Rruga e Kavajes no. 7
Tirana
Albania

Case Number **DC-P-DUR-1-16**
Assessee **Anita Jella**

OPINION

according to

The Constitution of the Republic of Albania, Annex "Transitional Qualification Assessment", Article B, paragraph 3, sub b) and

Article 49, paragraph 11 of the Law No. 84/2016 *On the transitional re-evaluation of judges and prosecutors in the Republic of Albania* (further: "Vetting Law").

Introduction

According to the Constitution of the Republic of Albania, Annex "Transitional Qualification Assessment", Article B, paragraph 3, sub b), "[International Observers] [...] are entitled to file [...] opinions on issues examined by the Commission and the Appeal Chamber [...]".

Article 49 paragraph 11 of the Vetting Law states that: "A written opinion by an international observer shall be considered to be a conclusion by the latter about a concrete circumstance during the re-evaluation process or conclusions to be made from facts in individual cases [...]".



Based on the above, I herewith file an

OPINION

about the need for the assessee, based on the provisions of Article 52 of the Vetting Law:

- 1) to provide evidence about the existence of an effective and efficient roster system, in August 2019, in the Durres Prosecution Office; and
- 2) to provide evidence that would justify her lack of control of the registration/investigation, in the Durres Prosecution Office, of the name of Judge as a result of the criminal denunciation received by the Serious Crimes Prosecution Office and, then, transferred to the Durres Prosecution Office.

Failure to provide the said evidence should be considered within the framework of the assessment as per Article 59, paragraph 1, sub c) of the Vetting Law or within the framework of the overall assessment as per Article 4, paragraph 2 of the Vetting Law.

Circumstances grounding the Opinion

The ineffective and inefficient roster system in the Durres Prosecution Office

In replying to the second issue for which the Independent Qualification Commission (further "IQC") has requested clarifications to the assessee by email sent on 5 November 2019 it is evident that, in reference to the criminal proceeding against *et al.*, three prosecutors were involved in the very initial stage of the investigation, namely (Friday 9th- Saturday 10th August 2019), (Sunday 11th August 2019) and (Thursday 28th August 2019). The assessee offered some justification to the said assignments.

However, the International Observer is of the Opinion that the involvement of three different prosecutors at the very initial stage of the investigation even if the month of August is at stake does not show a proper handling of the resources of the office and of the on call system, as similar modalities as those occurred in the aforementioned case can go, at the very end, to the detriment of a proper investigation.

The lack of registration and/or investigation against Judge in Durres Prosecution Office (ref. case No. /2019)

Following information received by the IQC, it appears that on 16 May 2019 citizen has filed to the Serious Crimes Prosecution Office in Tirana a criminal denunciation against Judge and against citizen The criminal report was sent to the Durres Prosecution Office which registered the "Kallezim Penal nr. " of 2019 for "abuse of office", ONLY against Following the analysis of the developments of this criminal case, it does not result that any criminal investigation or proceeding was ever registered/conducted against



It is very concerning the absence of control that should have been exercised by the assessee Ms. Anita Jella over the correct performance of the relevant acts of the proceedings related to corruptive-related allegations against a member of the judiciary. Specifically, the lack of supervision over the absent registration of the name of Judge ... and consequent absent investigation (or even possibility to assess whether an investigation had to start).

Conclusions

Considering the above, it is the Opinion of the International Observer that:

- 1) the assessee Ms. Anita Jella should have the burden to proof the existence of an effective and efficient roster system, in August 2019, in the Prosecution Office of Durres and that the IOC, based on the provisions of Article 52 of the Vetting Law, should request such evidence; and that
- 2) the assessee Ms. Anita Jella should have the burden to proof to justify her lack of control of the registration/investigation, in the Durres Prosecution Office, of the name of Judge ... as a result of the criminal denunciation received by the Serious Crimes Prosecution Office and, then, transferred to the Durres Prosecution Office and that the IOC, based on the provisions of Article 52 of the Vetting Law, should request such evidence.

Failure to provide the said evidence should be considered within the framework of the assessment as per Article 59, paragraph 1, sub c) of the Vetting Law or within the framework of the overall assessment as per Article 4, paragraph 2 of the Vetting Law.

Respectfully submitted,

International Observer

